

SHABAN DEMIRAJ

## RRETH MBARESAVET TË SHUMËSIT TË EMRAVET ASNJANËS NË GJUHËN SHQIPE.

Çdo gjuhëtar, që është marrë me përshkrimin ose me studimin e shumësive të emrave në gjuhën shqipe, ka ndeshur në një sërë vështirësish me karakter shkencor dhe praktik. Të kihen parasysh, p.sh., vështirësitë për të vendosur rregulla sa më të përgjithshme dhe me sa më pak përjashtime lidhur me formimin e shumësive, sidomos të emrave mashkullorë. Veç kësaj, këtu do përmendur se, me gjithë sukseset e arritura në studimin e strukturës gramatikore të shqipes së sotme letrare dhe në hulumtimet dialektore shqiptare, në mjaft raste është e vështirë të përcaktohet drejt norma letrare në lidhje me përdorimin e kësaj ose asaj mbarese shumësi. Mungesa e një studimi të posaçëm mbi shtrirjen dialektore dhe nëndialektore të formave të ndryshme të shumësive dhe mbi shkallën e pasqyrit të tyre në shqipen e sotme letrare, mund të çojë në qëndrime subjektive. Një studim i tillë, përveç interesit thjesht shkencor, ka edhe një rëndësi të madhe praktike, sidomos tashti që përcaktimi i normave të gjuhës letrare është bërë një detyrë e ngutshme.

Edhe më të mëdha janë vështirësitë, që paraqit shumësi i emrave nga pikëpamja e sqarimit historik. Nga kjo pikëpamje, me gjithë kontributet e dhëna nga gjuhëtarë të ndryshëm shqiptarë e të huaj, një varg çështjesh edhe sot e gjithë ditën mbeten të pazgjidhura në mënyrë të plotë. Është fjala, në radhë të parë, për sqarimin historik të mbaresave kryesore të shumësive. Disa nga këto, siç dihet, në shqipen e shkruar të shekujve të kaluar si edhe në shqipen e sotme i gjejmë të përdorura me emrat e të tri gjinive. Kështu, p.sh., me mbaresen *-a* e formojnë shumësin jo vetëm një varg emrash të gjinisë femërore si *pushë-push-a*, *kodër-kodr-a* etj., por edhe një sërë emrash mashkullorë si *lis-a*, *dem-a* etj. dhe një numër emrash, në origjinë, asnjane si *emër-emr-a*, *petk-a* etj. Për këtë dukuri të shumësive të emrave në gjuhën shqipe është e nevojshme të jepen sqarime sa më të argumentuara lidhur me arsëyet dhe mënyrën e përgjithësimin të disa mbaresave si formante shumësi për emrat e të tri gjinive.

Duke qenë se mjaft nga problemet, që paraqit shumësi i emrave të shqipes së sotme, është e vështirë të zgjidhen në mënyrë sa më të saktë pa një sqarim historik paraprak, në këtë artikull i kemi vënë vetes si detyrë të merremi vetëm me burimin e mbaresave kryesore të shqipes. Është fjala për mbaresat *-ë*, *-e*, *-a* dhe geg. *-(ë)na* tosk. *-(ë)ra*, të cilat në periudhën e dokumentuar të shqipes i gjejmë të përdorura me emra të të tri gjinive. E me që gjer më sot mungon një studim i veçantë mbi shumësin e emrave asnjane, vështruar histori-

kisht, në këtë artikull jemi nisur pikërisht nga këta emra. Por në analizën historike të mbaresave në shqyrtim shumësi i emrave asnjansës është vështruar në përjasje me atë të emrave mashkullorë e femërorë. Është vështruar kalimthi edhe origjina e mbaresës së shumësit -i. Sqarimi i origjinës së këtyre formanteve aq të përdorura të shqipes ka një rëndësi të veçantë për morfologjinë historike të shqipes, sidomos po të kihet parasysh se mendimet e shprehura gjer më sot mbi prejardhjen e disave prej tyre nuk pajtohen midis tyre. Megjithëkëtë, siç do të dalë edhe nga shtjellimi i këtij artikulli, kontributet e dhëna nga gjuhëtarë të ndryshëm për sqarimin e problemit në shqyrtim janë të një rëndësie të madhe. Këtu duan përmendur sidomos kontributet e H. Pedersenit dhe E. Çabejt, të cilët i kanë kush-tuar një vëmendje të veçantë gjinisë asnjansës të shqipes.

Shumësi i emrave asnjansës (të trashëguar ose të huazuar) të gjuhës shqipe në periudhën e dokumentuar të saj nuk paraqitet me një formë të vetme dhe as i dallueshëm për nga formantet prej shumësit të emrave të dy gjinivet të tjera. Emrat e shqipes, që në njëjës i gjejmë të përdorur si asnjansës, në shumës dalin me këto formante:

1) Me mbaresën -ë: *vësh-ë* (në njëjës asnjansës tek Buzuku: *vëshë-të*); *vjet-ë* (në njëjës asnjansës tek Buzuku e Budi: *vjetë-të*); *shenj-ë* (në njëjës asnjansës tek Buzuku: *shenj-të*) etj.

2) Me mbaresën -e: *faj-e* (në njëjës asnjansës tek Buzuku e Budi: *faj-të*; tek Bogdani haset si mashkullor), *gjq-e* (në njëjës asnjansës tek Buzuku, Budi e Bardhi: *gjq-i-të*), *dam-e* (në njëjës asnjansës tek Budi: *dam-të*, por edhe si mashkullor: *dam-i*) etj.

3) Me mbaresën -a: geg. *emën-a* tosk. *emër-a* (në njëjës asnjansës tek Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani etj.: *emën-i-të*); tek Matrënga haset si asnjansës dhe si mashkullor), *petëk-a* (në njëjës asnjansës tek Buzuku: *petëk-u-të*) etj.

4) Me mbaresën geg. -(ë)na tosk. -(ë)ra: *ujë-na* *ujë-ra* (në njëjës asnjansës tek autorët e vjetër si edhe në të folme të ndryshme: *ujë-të*); *mish-ë-na* (në njëjës asnjansës tek autorët e vjetër dhe në të folme të ndryshme: *mish-të*); *kro-e-na*<sup>2</sup> (në njëjës asnjansës tek Bogdani *krue-të*, por edhe si mashkullor: *kro-u*) etj.

5) Me mbaresën zero: *sy* (në njëjës asnjansës tek Buzuku: *sy-të*) *dru* (në njëjës asnjansës tek Buzuku: *dru-të*), *tru*<sup>3</sup>; *mua* (në njëjës asnjansës tek Buzuku: *mua*) etj.

6) Me metafonizimin e zanores së temës: anë: *enë* (në njëjës asnjansës tek Buzuku, Budi e Bogdani: *anë-të*; tek Bardhi e më ndonjë rast edhe tek Buzuku e Budi përdoret si mashkullor: *an-i*).

7) Me metafonizimin e zanores së temës dhe me mbaresën -(ë)na: *shtrat*: *shtretëna* (në njëjës asnjansës vetëm tek Buzuku: *shttratë*=*shttrat-të*; sh. *shtretëna*; sot: *shtret-ën*; tosk. *shtret-ër*).

1) Edhe në të folmen e qytetit të Gjirokastrës ky emër haset si asnjansës; shih M. Totoni, «St. Fil.» 1 (1966) 94.

2) Tek forma *kro-e-na* kemi dy mbaresa shumësi: -e dhe -na-. Forma më e përdorur e shumësit sot është *kronj-e* dhe *kroj-e*. Ky emër nuk dëshmohet gjëkund tjetër si asnjansës.

3) Këtë emër Pedersenit në K.Z. 34, 289, e supozon si asnjansës me temë në -u-. Këtë supozim të Pedersenit e përmend edhe Brugmann-i në «Grundriss...», II. Band, II. Teil, I. Lieferung, f. 234.

\* \* \*

Kjo polimorfi në shumicën e emrave asnjane është rrjedhimi i zhvillimit të brëndshëm historik të gjuhës shqipe. Nga formantet e lartpërmendura vetëm mbareja -ë është refleksi i drejtpërdrejtë i mbaresës së shumësive asnjane indoeuropiane -ā (nëpërmjet -ā).

Në bashkohemi me mendimin e Pedersenit<sup>4</sup> që tingulli fundor -ë i disa emrave asnjane si *ballë, ujë* etj. është ose refleksi i mbaresës së shumësive asnjane indoeuropiane -ā, ose është një shtesë analogjike. Bashkohemi gjithashtu edhe me mendimin e E. Çabejt<sup>5</sup> që -ë tek shumësi *vesh-ë* është refleksi i mbaresës -ā «të asnjaneve shumësive të mavave më -o të indoeuropianishtes».

Sipas mendimit tonë, si refleksi i mbaresës -ā të shumësive asnjane indoeuropiane duhet interpretuar edhe mbareja -ë e shumësive të emrave *vjet-ë<sup>6</sup>, shenj-ë, geg. kren-ë* tosk. *krer-ë*, tosk. *frer-ë* a *frër-ë<sup>7</sup>, brir-ë*, e ndofta edhe *drerë* a *drër-ë*. Megjithatë emrat geg. *brin-i, dren-i*, tosk. *brir-i, drër-i* nuk dëshmojnë gjëkund si asnjane në njëjës, mungesa e palatalizimit të hunders fundore të temës tek format e shumësive *brir-ë* (tema e hershme *brin-<sup>8</sup>*) dhe *drer-ë* a *drër-ë* (tema e hershme *dren-<sup>9</sup>*) na bën të mendojmë se këta emra në kohë të lashta mund të mos kenë qenë mashkullorë, por asnjane. Kurse format e shumësive tosk. *dru-rë<sup>10</sup>, tra-rë* a *tre-rë* (geg. *tre-në*)<sup>11</sup> ne i konsiderojmë analogjike, pra, sekondare.

Por do pasur parasysh se edhe shumë emra të gjinive femërore e mashkullore, si rrjedhim evolucionesh fonetike ose shtrirjesh analogjike, me kohë e kanë formuar shumësin me mbarejen -ë.

Tek shumësi i emrave femërorë të tipit *punë* kjo -ë duhet të jetë refleksi i +-ās nga +-āes<sup>12</sup> të emërores shumësive ose i +-ās nga +-ans<sup>13</sup> të kallzores shumësive të emrave me temë në -ā, ose i të dyjave së bashku.

4) K. Z. 34, 289; 36, 339. Shih edhe N. Jokl, I. F. 36, 153, 202 etj.

5) «Bul. Shk. Shoq.» 3 (1955), 41.

6) Ky emër tek Buzuku në shumësin e pashquar del në formën *vjet-ë* e në të shquarin *vjetë-të*. Këto forma përdor zakonisht edhe Budi, por te ky autor në 2 raste (Sp. C., f. 10, 400) haset edhe forma, sipas nesh, më e re e shumësive të pashquar *vjet*, e cila përdoret sot pothuaj kudo (në toskërishte krahas formave edhe më të reja *vite, vitëra* e *vitra*). Opozicioni më i hershëm njëjës: shumësive duhet të ketë qenë *vjet: vjetë*. Tek forma e njëjësive *vjetë*, që haset tek autorët e vjetër, -ë-ja është sekondare, e përfutur, me sa duket, nën ndikimin e formës së shumësive.

7) Formën asnjane të këtij huazimi latin në njëjës na e dëshmon fjalori i Bardhit, f. 27: *Fraenum equi — Fretë* e kälit.

8) Për format e shumësive të këtij emri në gegërishte shih më tutje shën. 21.

9) Forma e shumësive *drëj* (< *drenj*), që jep «Bashkimi» për shkodrënishten, sipas nesh, është analogjike, pra, sekondare.

10) Emri *dru* në origjinë nuk ka qenë me temë në -n; shih E. Çabej, «Bul. USHT., Seria Shk. Shoq.» 3 (1961), 62. Në të mirë të kësaj teze flet edhe forma e rrjedhore *ndrui* (n+*dru*), që gjejmë tek Buzuku në f. 144/b (...përmbi një pjergullë n *dru*...), tek Budi në RR, 50 (...e me rietzët hekuri o *ndrui mbërshelë*...) dhe tek fjalori i Bardhit, f. 48 (*Ligneus — ndrui*).

11) Edhe emri *tra*, nga lat. *trabem* (shih Meyer, E. W. 433), në origjinë nuk ka qenë me temë në -n. Vërejtjet e Joklit (I. F. 36, 100, 101, 105, 131) lidhur me këtë shpjegim të Meyer-it nuk duken bindëse.

12) Për evolucionin +-āes > +-ās shih Brugmann, *vep. cit.* 211.

13) Për reduktimin e +-ans në +-ās shih Burgmann, *po aty*, 117. Shih edhe E. Fleury, *Morphologie historique de la langue grecque*, Paris, 1936, f. 102; si edhe A. Ernout, *Morphologie historique du latin*, Paris, 1935, f. 27.

Kurse tek shumësi i emrave mashkullorë të tipit *gur-ë* mbaresa -ë ka më shumë të ngjarë të jetë shtrirë për analogji nga shumësi i emrave asnjans<sup>14</sup>. Por nuk përjashtohet mundësia që tek shumësi i emrave mashkullorë mbaresa -ë të jetë pjesërisht edhe refleksi i  $+ons$  (ndofta në përmjet evolucionit  $+ons > +ans > +ās > +ā > +ā > -ë$ ) të kallëzores shumë të emrave mashkullorë me temë në -o<sup>15</sup>. Na duket e vështirë që -o-ja e kallëzores së shumësit të këtyre emrave të jetë zhdukur pa lënë gjurmë, ashtu siç është zhdukur -o-ja e shkurtër e emërores dhe e kallëzores njëjës të emrave mashkullorë dhe asnjans me temë në -o<sup>16</sup>.

Lidhur me evolucionin e -ā në -ë do pasur parasysh se:

1) Ky evolucion, që duhet të jetë vërtetuar në të njëjtën kohë si tek shumësi i emrave asnjans ashtu edhe në shumësin dhe njëjësin e emrave femërorë me temë në -ā, është bërë në mënyrë të shkallëzuar:  $-ā > -ā > -ë$ , d.m.th. në mënyrë të njëjtë me atë të -ā-së fundore të emrave femërorë në numrin njëjës<sup>17</sup>.

2) Shkalla e fundit e këtij evolucioni (ā > ë) duhet të jetë vërtetuar, pasi kishte përfunduar procesi i rregullimit mekanik të theksit, që, siç e kanë vërtetuar Majer-Lybkeja dhe Jokli<sup>18</sup>, ka ndodhur në kohën e sundimit romak. Si terminus a quo për shkallën e fundit të evolucionit në fjalë mund të caktohet, në vija të përgjithshme, periudha e fundit e sundimit romak në Shqipëri.

\* \* \*

Pra, në një fazë të dhënë të zhvillimit të shqipes së përbashkët, që nuk duhet të jetë më e vonë se shekujt e fundit të sundimit romak në Shqipëri, emrat e gjinisë asnjansë, një shumicë emrash të gjinisë femërore si edhe një pjesë emrash të gjinisë mashkullore e formonin shumësin me mbaresën -ë. Kjo homonimi formash të emrave të të tri gjinive në shumësi si edhe homonimia e formave të njëjësit e të shumës tek një pjesë e mirë emrash, sidomos femërorë, nuk mund të mos zhvillojnë me kohë prirjen për një diferencim të ri të formave të shumësit me anë mbaresash më shprehëse. Këtë fenomen, që nuk kemi mundësi ta gjurmojmë në mënyrë të dokumentuar për periudhën paraletare të shqipes, jemi në gjendje ta konkretizojmë për këta shekujt e fundit me anë të një numri jo të

14) Me sa duket, këtë ka dashur të shprehë edhe M. Domi në dispensën e tij «Morfologjia historike e shqipes», Tiranë 1961, f. 7, kur thotë: «Ajo [mbaresa e shumësit -ë e emrave mashkullorë e femërorë — Sh. D.] ka ardhë nga një a që mund të lidhet me prapashtesën e vjetër indoeuropiane a (krahaso shumësat e emrave asnjans latinë, si templum *templa*, cubile *cubilia*».

15) Një mendim i ngjashëm është shprehur edhe më parë. Për këtë shih M. Domi, dispensa e cituar, f. 7, ku thuhet: «Disa e nxjerrin nga një mbaresë e kallzores shumë të emrave atematikë -ans < -ons».

16) Në bashkohimi me mendimin e Pedersenit (K. Z. 34, 288) që -ë «nuk është vazhdimi i rregullt i fundores indoeuropiane -om; në kallëzoren mashkullore nuk gjëndet asnjë gjurmë e ndonjë ë-je». Neve nuk na rezulton që Pedersenit më vonë në K. Z. 36, 314 ta ketë ndryshuar këtë mendim, ashtu siç shkruan Jokli në I.F. 36, 114. Pedersenit në K. Z. 36, 314 bën fjalë për kthimin e -a-së së kallëzores së dëftorit njënjës në -ë nën ndikimin e hundores ndjekëse. Pra në këtë rast është fjala për një -a të theksuar dhe të hundorizuar, reflekse të një  $+om$  dhe  $+ām$ .

17) Për këtë shih G. Meyer, «Alb. St.» III, 83. Por, sipas mendimit tonë, rezerva e shprehur nga Meyer-i me fjalën «Wahrscheinlich» është e tepërt.

18) W. Meyer-Lübke, *Romanisch, Albanesisch, Heidelberg* 1914, f. 20-21; N. Jokl, I. F. 36, 119-120.

vogël emrash asnjanës, dhe jo vetëm asnjanës. Ja disa shëmbëlla sa për sqarim:

Tek Buzuku emrin asnjanës *shenj-të* në shumës e gjejmë të përdorur jo vetëm në formën më të vjetër *shenj-ë*, por edhe në formën më të re *shenj-a*.

Emri *krye* tek Buzuku në shumës haset në formën *kren-ë* si në kuptimin «kokë» ashtu edhe në kuptimin «prijës». Edhe tek Budi haset vetëm forma *kren-ë*, kurse Bogdani përdor formën më të re *kren-a*. Por në gegërishten veriore sot përdoren të dy format, *kren-ë* në kuptimin «prijës» dhe *kren-a*<sup>19</sup> në kuptimin «kokë».

Të krahasohet edhe forma *frer-ë* a *frër-ë* me formën më të re *fren-a* si edhe me formën analogjike *frë-j* (nga *frenj*) të gegërishtes veriore<sup>20</sup>. Gjithashtu të krahasohet edhe forma *brir-ë* me format *brin-a* dhe *brî-j* (nga *brinj*) të gegërishtes veriore<sup>21</sup>.

Sipas mendimit tonë, edhe *gjër-a*, *zër-a* (geg. *gjan-a*, *zan-a* dhe *zan-e*) duhet të kenë zëvendësuar forma më të vjetra shumësi +*gjër-ë*, +*zër-ë* (geg. +*gjan-ë*, +*zan-ë*), ku mbaresa *-ë* reflektonte mbaresën e vjetër *-a* të shumësit asnjanës. Për origjinën asnjanëse të këtyre dy emrave në shumës fletë qartë, sipas mendimit tonë, edhe mungesa e palatalizimit të hundores në shumës<sup>22</sup>.

Sipas mendimit tonë, edhe format e shumësit *gjinj* dhe *barqe* të emrave asnjanës *gji-të*<sup>23</sup> dhe *bark-të* duhet të kenë zëvendësuar forma shumësi më të vjetra më *-ë*: geg. +*gjin-ë* tosk. +*gjir-ë*, dhe *bark-ë*<sup>24</sup>.

Prirjen e gjuhës shqipe për të përdorur forma shumësi sa më shprehëse, na e dëshmon, ndër të tjera, edhe shumësi i emrit *mal*, i cili, sipas supozimit të Pedersenit<sup>25</sup> mund të ketë qenë asnjanës. Duke u mbështetur sidomos në faktin që ky emër edhe në shumës përdoret me *-l-* të pajotizuar, edhe ne mendojmë se në krye të herës ai nuk duhet të ketë qenë mashkullor, por asnjanës. Ky emër tek Buzuku na del

19) Formën më të re *kren-a* e kanë edhe arbëreshët e Greqisë, siç na dëshmojnë Reinhold-i, N. P., Anth. 4, si edhe Cl. Haebler, *Grammatik der Alb. Mundart von Salamis*, 102.

20) Kristoforidhi në fjalorin e tij si për gegërishten ashtu edhe për toskërishten jep si formë shumësi *frenj-të*, kurse «Bashkimi» jep vetëm formën *gege frëi-t*. Formën *frënj* për toskërishten e shënon edhe fjalori i Drizarit e pas tij edhe fjalori i Mann-it. Sipas një kumtimi të M. Totonit, në Përmet thuhet *frenjat e rrushit*, kurse në Labovë të Kryqit, sipas një kumtimi të E. Lafes, thuhet *frërët e rrushit*.

21) Fjalori i Kristoforidhit për gegërishten jep formën e shumësit *brî-të* e për Shkodër *briena-të*, kurse për toskërishten jep *brinj-të* (sic!). «Bashkimi» jep për gegërishten veriore *brina*.

22) Do pasur parasysh se Pedersenit në K. Z. 34, 291 ka shprehur supozimin se emri *gjë* (ashtu si *sy* dhe *vend* që pësojnë ndërrim gjinie në shumës) në origjinë ka qenë asnjanës. Këtë supozim e ka miratuar dhe argumentuar E. Çabej në «Bul. Shk. Shoq.» 3 (1955), 40, si edhe në *Shumësi i singularizuar*, (Tiranë, 1967), f. 155. Siç e ka vënë në dukje edhe E. Çabej, ky emër në njëjës përdoret edhe si mashkullor: *gjër-i*. Të kihet parasysh edhe togfjalëshi arkaik (*si*) *pa gjë të keq*, ku forma e mbiemrit mund të interpretohet barabar si mashkullore ose asnjanëse.

23) Në njëjës asnjanës tek Bogdani *gji-të*. Ky emër, për nga origjina, është me temë në *-n*; shih Meyer, E. W. 140.

24) Ndërsa Budi, Bardhi e Bogdani këtë emër asnjanës në njëjës e shkruajnë rregullisht *bark-të*, Buzuku e shkruan herë *bark-të*, herë *barkë-të*, në trajtë të pashquar *bark*. Ne mendojmë se tek *bark-ë-të -ë-ja*, në rast se nuk është shtuar për analogji me asnjanësit e tjerë, ndofta reflekton mbaresën e vjetër të shumësit asnjanës *-a*.

25) K. Z. 34, 291.

me dy forma shumësi *-mal* dhe *mal-e* — në një raport dëndurie 9:8. Formën e shumësit *mal-të*, e cila ka shumë të ngjarë të jetë vazhdimi i një forme më të hershme *+mal-ë-të*, e gjejmë edhe tek Budi<sup>26</sup> si edhe tek arbëreshët e Italisë<sup>27</sup>.

\* \* \*

Mbaresat e tjera, me të cilat e gjejmë të formuar shumësin e emrave asnjëherë në periudhën e dokumentuar të shqipes, janë: 1) *-e*; 2) *-a*; 3) geg. *-(ë)na* tosk. *-(ë)ra*. Duke qenë se *-(ë)na* dhe *-(ë)ra*, siç e kemi vënë në dukje edhe në artikullin tonë «Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në shumë, vështuar edhe në përqsaje me rumanishten»<sup>28</sup>, kanë dalë nga zgjërimi i mbaresës *-a*, këtu do të ndalemi më parë në shqyrimin e mbaresave *-e* dhe *-a*.

Në radhë të parë, do pasur parasysh se këto dy mbaresat me këtë paraqitje fonetike duhet të jenë reflekse formantesh më të hershme, që me kalimin e kohës kanë evoluar fonetikisht.

Mendimi i Pedersenit<sup>29</sup>, i miratuar edhe nga Jokli<sup>30</sup>, që mbaresat *-e* është refleksi i indoeuropianishtes *+ -ās*, na duket i pambrojtshëm, pasi, siç dihet, *-ā* në pozicion fundor ka dhënë rregullisht *-ë*, kurse *-s* ka rënë që herët pa lënë asnjë gjurmë. Zonorja *-ā* në pozicion fundor, edhe kur ka qenë e theksuar dhe e ndjekur nga një hundore, në të folmet toske me kohë ka dhënë prapë *-ë*, siç na dëshmon kallëzoria njëjës e dëftorit (a-) të (mashkullor e femëror) nga *\*tóm* dhe *\*tam*<sup>31</sup>.

Edhe mendimi i Majerit<sup>32</sup>, i miratuar edhe nga M. Domi, që *-e* e shumësit është refleksi i diftongut indoeuropian *+ -oi* nëpërmjet *+ -ai*, na duket i papranueshëm. Në radhë të parë, do pasur parasysh se ka shumë pak të ngjarë që diftongu indoeuropian *+ -oi* në fund të fjalës (aq më shumë në pozicion jashtë theksit), të ketë dhënë *-e*, ashtu siç ka dhënë në trup të fjalës.

Së dyti, do pasur parasysh se *+ -oi*, me origjinë përemërore<sup>34</sup>, ashtu si në disa gjuhë të tjera indoeuropiane si latinishtja, greqishtja, keltishtja dhe gjuhët balto-sllave<sup>35</sup>, edhe në gjuhën shqipe ka shumë të ngjarë të ketë dhënë mbaresën *-i*<sup>36</sup>.

26) Gjithë *mallë* i kaptoi (D.C. 199). Këtë formë shumësi të Budi e kemi hasur vetëm 2 herë.

27) M. Marchianó, *Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia*, Foggia, 1908, ku krahas formës së vetme të shumësit me *-e* malezit të lertë (f. 10) gjejmë: nëndë *malj* (f. 48, shkruar: *magl*); kta *malj*, kta *maljzit* të shkretë (f. 76, shkruar: *magl, maglzit*); në kta *mals*, në kta *malzit* të vo shkret (f. 86).

28) «Studime Filologjike», 4 (1966), 92.

29) Rom. Ib. I, 209.

30) I. F. 36, 163-4.

31) Meyer, «Grammatik», 4; Pedersen. K. Z. 36, 314.

32) Alb. St. I, 96.

33) Dispensa e cituar, 6.

34) Brugmann, *vepër cit.*, 212.

35) Brugmann, *po aty*, 212.

36) A.V. Desnickaja në kumtesën *Реконструкция элементов древнеалбанского языка и общепалкские лингвистические проблемы*, Москва, 1966, f. 21 ka shprehur mendimin se formanti i numrit shumësi *-i* (nga *-ī*) «mund ta ketë burimin tek mbaresat e rasës emërore e numrit shumësi të temave me *-i* të protoshqipes (krahas gjermanishtes e përbashkët *-iz* prej i.e. *-ies*)». Ajo shton se që këtej «mbaresa *-i*, pas gjithë gjasash, nëpërmjet analogjisë morfologjike u shtri në një numër të madh temash të tjera emërore, sidomos depërtoi në paradigmen e temave

Kjo, siç dihet, ka shkaktuar që herët në shqipe fenomene me karakter morfofonologjik, siç janë metafoia  $a > e$ , palatalizimi i bashkëtingëlloreve fundore  $-k, -g, -n, -ll, -l, -r$ , ose të dyja këto fenomene së bashku p.sh.: *dash*: *desh*  $< +dash-i$ ; *ulk*: *ulq* (sot *ujq*)  $< +ulk-i$ ; *zog*: *zogj*  $< +zog-i$ ; *glu(n)*: *glunj* (sot *gjunj*)  $< +glun-i$ ; *diell*: *diej*  $< +diell-i$ ; *plak*: *pleq*  $< plak-i$ .

Me këtë rast e quajmë të nevojshme të theksojmë edhe se mendimi i Majerit<sup>37</sup> që mbaresa  $-i$  në shqipe të jetë prej burimi latin, është i pambrojtshëm për këto arsye:

a) Këtë mbaresë shumësi me origjinë përemërore nuk e ka pasur vetëm latinishtja, por edhe gjuhë të tjera si greqishtja, keltishtja, gjuhët balto-sllave. Në rrethana të tilla nuk ka përse të mendohet që këtë mbaresë shqipja duhet ta ketë marrë pa tjetër nga latinishtja.

b) Emrat me origjinë latine kanë hyrë në gjuhën shqipe, rregullisht, në formën e kallëzores njëjës<sup>38</sup>.

c) Veç kësaj, do mbajtur parasysh edhe fakti i vënë në dukje së pari nga Pedersen<sup>39</sup> që ndikimi i latinishtes mbi strukturën gramatikore të shqipes ka qenë baras me zero. Në të tilla rrethana nuk mund të mos bëhet pyetja se si është e mundur që shqipja të ketë marrë nga latinishtja pikërisht atë mbaresë shumësi, e cila që në kohë relativisht mjaft të vjetra ka shkaktuar ndryshime aq të mëdha, siç janë metafoia dhe palatalizimi i disa tingujve fundorë. Një mbaresë e huaj, e cila do të ishte ndjerë për një kohë të gjatë si «mish i huaj» në strukturën gramatikore të shqipes, nuk mund të bëhej shkak për evolucionet të tilla të hershme.

Si rrjedhim, ne mendojmë se origjina e mbaresës  $-e$  të shqipes nuk duhet kërkuar as tek indoeuropianishtja  $-ās$ , siç e shpjegoi Pedersen, as tek diftongu indoeuropian  $+oi$ , nëpërmjet  $+ai$ , siç e shpjegoi Meyer-i.

Si përfundim, mund të pohohet me siguri se mbaresa e shumësit  $-e$ , për nga origjina, nuk mund të ketë qenë një mbaresë shumësi e emrave asnjane. Origjina e saj duhet kërkuar në zhvillimin e brendshëm të shqipes. Ka mjaft të ngjarë që ajo ta ketë burimin tek forma e shumësit të emrave femërorë të tipit *nuse*, që dalin njësoj si në njëjës edhe në shumës<sup>40</sup>. Nga shumësi i emrave femërorë kjo mbaresë, sipas men-

më  $-o-$ . Ka të ngjarë që ky proces të ketë filluar që në periudhën e protoshqipes».

Një mendim të tillë autorja e ka shprehur edhe në studimin *О категории числа в албанском языке* botuar në «Проблемы сравнительной филологии», Москва—Ленинград, 1964, f. 172, ku citon edhe studimin e njohur të N. Joklit *Griechisch-albanische Studien*, f. 92-93. Në këtë studim Jokli ka vërtetuar ekzistencën e emrave asnjane me temë në  $-i-$  në shqipen e stërlashtë, duke sqaruar se fjala *elb* është vazhdimi i një forme të shumësit asnjane  $*albhi$  (njëjës:  $*albhi$ ). Ai përmend aty edhe formën e metafizuar të shumësit *net* nga  $*naktis < *noqtis$  dhe me sa duket, Desnickaja këtë tip shumësi ka pasur parasysh për të mbështetur mendimin e saj. Por neve na duket shumë e vështirë që mbaresa  $-i$  e shumësit të emrave mashkullorë ta ketë burimin tek tingulli fundor ( $-i$ ) i shumësit të emrave të këtij tipi, të cilët duhet të kenë qenë tepër të kufizuar në shqipen e stërlashtë.

37) Alb. St. I, 96.

38) Për këtë shih E. Çabej, *Shumësi i singularizuar*, 136.

39) Rom. Jb. IX, I, 206 e vazhdim. Lidhur me këtë çështje shih edhe shën. 20 të artikullit tonë të cituar në «St. Fil.» 4 (1966), 87. Mendimin e Meyer-it mbi origjinën latine të mbaresës së shumësit  $-i$  nuk e ka pranuar as A. V. Desnickaja (shih studimin e cituar *О категории числа* f. 172, shën. 14).

40) Një supozim të tillë e ka bërë më parë E. Hamp në artikullin «Gender shift in Albanian», botuar në «Romance Philology», vol. XII, 2 (1958), f. 149. Ai e nxjerr këtë  $-e-$  nga  $-iā(s)$  e kallëzores së shumësit të emrave femërorë të ti-

dimit tonë, erdh e u shtri edhe në shumësin e disa emrave asnjanes e që këtej edhe në shumësin e disa emrave mashkullorë jofrymorësh si *vend-e*, *gëzim-e* etj. Përdorimi i një mbarese shumësi me emra gjinish të ndryshme, sidomos kur është fjala për emra jofrymorësh<sup>41</sup>, është një fakt i njohur në gjuhën shqipe<sup>42</sup>.

\* \* \*

Përsa i takon mbaresës *-a*, mendimi i Majerit<sup>43</sup> që kjo të jetë refleksi i indoeuropianishtes *-ās* (të shumësit të femërorëvet me temë në *-ā*) është i pambrojtshëm për arësyet fonetike, që u vunë në dukje më sipër. Për të njëjtat arësye nuk mund të pranohet as mendimi i E. Hempit (Hamp)<sup>44</sup> që *-a* e shumësit mund të vijë nga *+ans* e kallëzores shumës, e cila nuk mund të jepte tjetër veçse *-ē* (nëpërmjet  $\bar{a} > \bar{ē}$ ).

Më i pranueshëm fonetiki duket shpjegimi i Pedersenit<sup>45</sup>, sipas të cilit mbarese *-a* e shumësit ka dalë nga shkrirja e *-ē-së* fundore të emrave të tipit *burrë* me mbarese *-e*. Në të mirë të këtij shpjegimi, të miratuar edhe nga Jokli<sup>46</sup>, do të fliste edhe fakti që asnjë emër (i çfarëdo gjinie) me temë në *-ē* nuk del në shumës me mbarese *-e*.

Por në do të shtonim se shkrirja  $\bar{e} + e = a$  duhet të jetë vërtetuar në krye të herës tek emrat femërorë të tipit *pushë*, që prej kohësh përbëjnë shumicën dërmonjëse të emrave femërorë. Në të mirë të këtij mendimi do të fliste edhe fakti që mbarese *-a* është përgjithësuar prej kohësh si morfemë karakteristike e shumësit të mbiemrave femërorë të tipit e *bardhë*: të *bardh-a*, ku do të ketë kaluar nga shumësi i emrave femërorë.

Mbarese *-a*, duke qenë fonetiki mjaft e dallueshme si morfemë shumësi<sup>47</sup>, me kohë erdh e u përdor edhe me emrat asnjanes të tipit *emën-a*, *emër-a*, *petëk-a*, *gjan-a*, *gjër-a* etj. e nëpërmjet asnjanesvet kaloi edhe tek mashkullorët e tipit *lis-a*, *plep-a*, *burr-a* etj.

Megjithatë, mbetet për t'u shpjeguar përse kjo mbarese shumësi nuk është përgjithësuar tek të gjithë emrat femërorë me temë në *-ē*.

Në lidhje me mbarese *-e* e shumësit geg. *-(ë)na* tosk. *-(ë)ra* e quajmë të nevojshme të ritheksojmë<sup>48</sup> se ajo nuk ka të bëjë fare me mbarese *-ora* të asnjanesvet latinë, siç pohon dijetari italian G. Bonfante, miratuar pjesërisht edhe nga V. Pizani (Pisani)<sup>49</sup>. Përveç faktit që forma

pit *nuse*, duke ndjekur kështu, me sa duket, hullinë e Pedersenit, i cili në B.B. XIX. Band (1893), f. 295 ka shprehur mendimin se *-e* është refleksi i indoeuropianishtes *-ā* dhe *-iā*, kurse *-ā* dhe *-iā*, sipas tij, kanë dhënë *-ē*. Ky mendim i Pedersenit për evolucionin e *-ā* dhe *-iā* në *-e* mbetet për t'u vërtetuar. Ndërkaq, do pasur parasysh se edhe Pedersenit mbarese *-e* e shumësit *-e* e shpjegonte si femërore për nga origjina.

41) Mbarese *-a* e shumësit *-e* rregullisht përdoret me emra jofrymorësh. Format e shumësit *korb-e*, *urith-e*, *nxënës-e* etj. të nëndialektit të çamërishtes (shih artikullin tonë të cituar, f. 85), sipas nesh, duhet të jenë inovacione jo të vjetra.

42) Të kihet parasysh edhe përdorimi i mbaresevet të shumësit *-ē*, *-a* dhe geg. *-(ë)na*, tosk. *-(ë)ra* me emra të të tri gjinivet.

43) Alb. St. I, 97.

44) Art. cit., f. 149.

45) Alb. T., 10.

46) Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen, 92.

47) Për këtë shih E. Cabej, «Bul. USHT, Seria Shk. Shoq.» 3 (1963) 75.

48) Për këtë shih edhe artikullin tonë të cituar, f. 92.

49) «Paideia» XIX (1964), f. 302. Siç shënon Meyer-i, Alb. St. I, 102, edhe Schuchardt-i në K. Z. 20, 297 e pat krahasuar këtë mbarese shumësi të shqipes me *-ora* të italishtes dhe me *-uri* të rumanishtes. Meyer-i me të drejtë e kundërshton këtë krahasim.

gege me *-n-* mbetet e pashpjegueshme, pasi i ashtuquajtur «pseudo-restaurim» i invokuar nga G. Bonfante nuk është i argumentuar, do pasur parasysh edhe fakti i njohur që një *-ā* fundore e patheksuar prej burimi latin është reduktuar në *-ë*, ashtu si çdo *-ā* fundore e patheksuar në fjalët e trashëguara. Lidhur me këtë të kihen parasysh edhe huazimet latine të shqipes *pashkë*, *bukë*, *farkë* etj. (nga lat. *Pasque* ose *pascha*, *bucca*, *fabrica* etj.)

Për formimin e kësaj mbarese G. Majeri<sup>50</sup> ka shprehur mendimin se «geg. *-na* tosk. *-ra* janë ndërtime analogjike sipas shumësive me *-a* prej temave të më *-n* si *emna emra*». Këtë mendim kanë shprehur edhe M. Domi<sup>51</sup> dhe A. V. Desnickaja<sup>52</sup>.

Lidhur me formimin e kësaj mbarese do pasur parasysh edhe ky fakt gramatikor: ndërsa mbarese *-a* është përdorur prej kohësh jo vetëm me emra jofrymorësh (femërorë, asnjane dhe mashkullorë), por edhe me emra frymorësh (femërorë e mashkullorë), mbarese *-(ë)na* *-(ë)ra* është përdorur vetëm me emra jofrymorësh, kryesisht asnjane e femërorë, por aty-këtu edhe mashkullorë (si *fshat-ra*, *mall-ra*, *shi-ra*, *dhe-ra*). Sipas mendimit tonë, ka shumë të ngjarë që kjo morfemë ta ketë zanafillën tek shumësi i emrave *gjë*, zë: *gjan-a*, *gjër-a*, *zan-a*, *zër-a*, që në ndjenjën gjuhësore popullore janë interpretuar si *gja-na* *gjë-ra*, *za-na*, *zë-ra*. Ndërkaq, do pranuar edhe mundësia që në krijimin e kësaj morfeme të ketë ndikuar edhe shumësi i fjalëve të tilla si *emën emër* (*emën-a emër-a*), siç kanë pohuar Meyer-i, Domi dhe Desnickaja.

Kjo mbaresë duhet të jetë sajuar në një kohë kur përzierja e emrave të asnjane në shumësive më fort me femërorët ishte një proces i përfunduar. Prandaj kjo mbaresë shumësi në shqipe ka marrë në përgjithësi edhe një karakter femërorizonjës<sup>53</sup>.

\* \* \*

Përsa u takon emrave me origjinë asnjane *dru*, *tru*, *sy*, *muaj*, të cilët në shumësive dalin me të njëjtën formë si në njëjës, do të vërejmë:

a) *Dru* dhe *tru*, që janë pranuar si asnjane të trashëguar me temë në *-u*, duhet të jenë reflekse të formës së njëjësive, sepse format e shumësive më *-ū*<sup>54</sup> duhet të ishin reflektuar ndryshe në shqipe<sup>55</sup>. Tingulli *-n-* (tosk. *-r-*), është sekondar jo vetëm tek *dru-n-i* (tosk. *dru-r-i*), por edhe tek *tru-n-i* (tosk. *tru-r-i*)<sup>56</sup>.

b) Forma e shumësive *sy*, pa asnjë gjurmë hundoreje, dëshmon, sipas nesh, se *-n-* në njëjësive *sy-n-i* (tosk. *sy-r-i*) mund të jetë sekondare<sup>57</sup>.

c) Tek fjala *muaj* (geg. *muej*, kurse tek Buzuku e Budi *muoj*), në

50) Alb. St. I, 102-3.

51) Dispensa e cituar, 8.

52) Kumtesa e cituar Реконструкция, f. 21.

53) Për këtë shih art. tonë të cituar, 95-6.

54) Brugmann, *vep. cit.*, 117.

55) Për këtë shih E. Çabej, «Bul. USHT., Seria Shk. Shiq.» 3 (1961), 62, tek fjala *dru*.

56) Shih më sipër shënimet 3, 10.

57) Ndryshe mendon E. Çabej, «St. Fil.» 4 (1965), 63.

rast se etimologjia e Majerit<sup>58</sup> është e drejtë, tingulli fundor -j duhet të jetë sekondar si në njëjës edhe në shumës<sup>59</sup>.

d) Tek forma e shumësit *enë-të* krahas *anë-të*<sup>60</sup> (në njëjës asnjans: *anë-të*, por edhe mashkullor *an-i*), -ë duhet të jetë refleksi i mbaresës së shumësit asnjans indoeuropian -a: nga forma e shumësit -ë kaloi edhe tek forma e njëjësit, siç ka ndodhur edhe me asnjans të tjerë si *vjet-ë-të*, *vesh-ë-të* etj. Metafonia a:e tek forma e shumësit *enë* është analogjike, pra, sekondare.

Analogjike duhet të jetë edhe metafonia tek forma e shumësit *shtret-ëna*.

\* \* \*

Nga sa u shtjellua në këtë artikull, del se dallimi formal i dikurshëm i emrave asnjans nga emrat e dy gjinivet të tjera në numrin shumë ka ardhur duke u zhdukur gjatë zhvillimit të brendshëm historik të shqipes. Në zhdukjen e këtij dallimi formal një rol vendimtar kanë luajtur reduktimi i -ā-së fundore në -ë dhe më vonë përdorimi i asnjansvet në shumës me mbaresa, që, për nga origjina, nuk ishin të gjinisë asnjansë. Natyrisht, në zhdukjen e dallimit formal në shumës ndërmjet emrave asnjans dhe atyre të dy gjinivet të tjera kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë si uniformimi i hershëm i nyjevet shquese dhe i mbaresave të rasave të zhdrejta për të tri gjinitë në shumës etj.<sup>61</sup>

## R é s u m é

### A PROPOS DES DÉSIGNENCES DU NEUTRE PLURIEL EN ALBANAIS.

*Le but principal de cette communication est de contribuer à l'éclaircissement de l'origine des désinences -ë, -e, a- et guëgue -(ë)na tosque -(ë)ra, que l'on trouve dans l'albanais écrit comme morphèmes du pluriel des neutres, aussi bien que des féminins et des masculins.*

*L'auteur admet l'opinion de H. Pedersen que l'-ë final des neutres du type ballë, ujë est le réflexe du neutre pluriel i.e. -ā, ou une extension de l'analogie. L'auteur admet aussi l'avis de E. Çabej que l'-ë du pluriel vesh-ë tire son origine de la même désinence du neutre pluriel i.e. -ā. Selon l'auteur de cette communication, on doit interpréter aussi comme réflexe de la désinence du neutre pluriel -ā l'-ë du pluriel des noms originellement neutres vjet-ë, shenj-ë (chez Buzuku), kren-ë (tosque krer-ë), tosque frer-ë ou frër-ë, brir-ë et peut-être même drer-ë ou drërë. La nonpalatalisation de la nasale finale du thème au pluriel de bri et dre (brir-ë et drer-ë de \*brin-ë et \*dren-ë), qui sont attestés partout comme masculins, peut être considérée comme un indice de leur origine neutre.*

*En ce qui concerne la désinence -ë du pluriel féminin du type punë, elle tire son origine soit de \*-ās < \*-aes du nominatif pluriel des fémi-*

58) E. W. 288.

59) Pedersen, *Festskrift til Vilhelm Thomsen*, f. 247. Mendimin e Pedersenit e vë në dyshim E. Çabej në *Shumësi i singularizuar*, 119.

60) E. Çabej, «Bul. USHT. Seria Shk. Shoq.» 4 (1960), 18-19.

61) Me çështjen e zhdukjes graduale të gjimisë asnjansë në njëjës dhe në shumës shpresojmë të merremi më gjatë në një punim tjetër.

nins en -ā, soit de \*-ās < \*-ans de l'accusatif pluriel, soit de ces deux désinences i.e. à la fois. Par contre, l'-ë du pluriel masculin (gur-ë, shok-ë etc.) est plus probablement une extension de l'analogie de la désinence du neutre pluriel. Mais il se peut fort bien que l'-ë du pluriel de certains masculins soit le réflexe de \*-ons (peut-être à travers l'évolution \*-ons > \*-ans > \*-ās > \*-ā > -ā > -ë) de l'accusatif pluriel des masculins en -o-.

L'auteur est de l'avis de G. Meyer que l'-ā a évolué en -ë à travers l'ä. Comme terminus a quo pour l'évolution -ā > -ë l'auteur détermine la phase finale de la domination romane en Albanie.

\* \* \*

L'avis de Pedersen, approuvé aussi par Jokl, à savoir que la désinence du pluriel -e soit le réflexe de l'i.e. -ās n'est pas admissible, parce que \*-ās en albanais a abouti à -ë. De même l'opinion de Meyer, approuvé aussi par M. Domi, que la désinence du pluriel -e tire son origine de l'i.e. \*-oi, à travers \*-ai, semble inadmissible à l'auteur de la communication pour les raisons suivantes: 1° L'i.e. \*-oi (en position finale inaccentuée) a dû être reflété différemment de l'\*-oi- (accentué dans le corps du mot). 2° L'\*-oi a évolué en \*-i, comme en latin, en grec, en celtique et dans les langues balto-slaves. L'opinion de Meyer, que la désinence \*-ī de l'albanais antique soit d'origine latine, est sans fondement.

D'après l'avis de l'auteur, l'origine de la désinence -e doit être cherchée dans le développement interne de l'albanais. Elle a tiré son origine de la forme du pluriel féminin du type nus-e. Ce morphème, étant plus marquant que l'-ë, a passé des féminins au pluriel de certains neutres et, à travers ceux-ci, au pluriel de certains masculins indiquant des objets inanimés.

\* \* \*

Pour ce qui est de la désinence -a, soit l'opinion de Meyer la faisant dériver de l'i.e. \*-ās, soit la supposition de E. Hamp qu'elle reflète l'i.e. \*-āns sont inadmissibles, parce que \*-ās et \*-āns ont abouti à -ë dans l'albanais. D'après l'auteur de la communication, la seule explication juste reste celle de Pedersen, qui la fait dériver de la fusion de l'-ë final du thème avec la désinence du pluriel -e. Mais il est d'avis que cette crase s'est avérée dans le pluriel des féminins du type fushë (fushë+e = fusha), et non pas dans le pluriel des masculins du type burrë, comme Pedersen en pensait. Selon l'auteur, l'emploi de la désinence du pluriel -a, étant plus expressive, s'est étendu avec le temps au pluriel des neutres du type emën-a (tosque emër-a) et, à travers ceux-ci, même au pluriel de certains masculins tels que lis-a, viç-a, burr-a, etc.

En ce qui concerne la désinence -(ë)na (tosque -(ë)ra), l'auteur est d'accord avec Meyer, Domi et Desnickaya, à savoir qu'elle doit son origine à un élargissement de la désinence -a. Mais, tandis que les linguistes susmentionnés cherchent l'origine de cet élargissement dans le pluriel des noms du type emën-a, l'auteur la cherche dans le pluriel des noms, selon lui, originaires neutres de thème en -n: gjā, zā (tosque

gjë, zë). Les formes du pluriel gjan-a, zan-a (tosque gjër-a, zër-a), confrontées à celles du singulier gjâ, zâ (tosque gjë, zë), ont été interprétées par le sens linguistique populaire comme gja-na, za-na (tosque gjë-ra, zë-ra). Cette nouvelle désinence s'est étendue des neutres aux féminins et même à certains masculins inanimés.

Par conséquent, la désinence élargie -(ë)na -(ë)ra n'a rien à faire avec l'-ra du latin, comme en pensent certains linguistes (tel que G. Bonfante).

\* \* \*

Dans cette communication l'auteur a voulu exprimer son opinion même sur les formes de pluriel des vieux neutres dru, tru, sy, muaj et anë (=enë).

\* \* \*

En concluant l'auteur affirme que la distinction de forme entre le pluriel des neutres et celui des noms des deux autres genres a disparu pendant l'évolution historique de l'albanais. La disparition de cette distinction est due en grande partie à la réduction de l'-ā final en -ë et à l'emploi ultérieur des neutres au pluriel avec des désinences qui n'étaient pas d'origine neutre. L'auteur a l'intention de s'occuper plus particulièrement de ce dernier problème dans un autre travail.